



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:161480
Datë: 12.01.2024
Numri i dokumentit: 05182899

PA1.nr.1617/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Pergjithshem, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me praktikantin gjyqesor Arben Arifi, si procesmbajtës në lëndën penale ndaj të akuzuarve Personi juridik – ‘D...’ SH.P.K me seli ne fshatin..., K. Prizren te cilën e përfaqëson personi i autorizuar i biznesit I.M., si dhe të akuzuarit B.M., person përgjegjës i personit juridik ‘D...’ SH.P.K, nga fshati..., K. Prizren, per shkak te vepres penale Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 par.1 të KPRK-së, per te vendosur sipas ankesës se Prokurorisë Themelore ne Prizren, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1060/20 të datës 06.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 04 Janar 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore ne Prizren, ndersa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1060/20 të datës 06.11.2023, **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1060/20 të datës 06.11.2023, i akuzuari Personi juridik ‘D...’ SH.P.K, te cilën e përfaqëson I.M., eshte shpallur fajtor per shkak te vepres penale, Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 par.1 të KPRK-së, per te cilën i eshte shqiptuar denimi me gjobë ne shumë prej 1,500 (njëmijë e pesëqind) euro, e gjithashtu B.M., si person përgjegjës i personit juridik ‘D...’ SH.P.K eshte shpallur fajtor per shkak te vepres penale Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 par.1 të KPRK-së, per te cilën i eshte shqiptuar dënimi me gjobe ne shume prej

500 (pesëqind) euro e te cilat gjoha janë të obliguar që t'i paguajnë në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Të akuzuarit janë obliguar që secili veç e veç t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale që dalin sipas llogaritave të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor shumen prej nga 20 (njetzet) euro, si dhe për fondin e kompensimit të viktimave të krimit shumen prej nga 20 (njetzet) euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankese ka ushtruar :

Prokuroria Themelore në Prizren, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet, dhe të akuzuarve për veprën penale për të cilën janë shpallur fajtorë të iu shqiptohen dënime më të larta e të cilat do të jenë në proporcion me peshën veprës penale të kryer e me të cilat dënime do të arrihej qëllimi i dënimit i parapare me nenin 38 të KPRK-së.

Prokurori i Apelit të Kosovës, duke u shkajuar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren, me shkresën e vet PPA.II.nr. 1650/2023 të datës 21.12.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit të Kosovës, Prokurorisë Themelore në Prizren ta aprovojë si të bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të akuzuarve të iu shqiptohen dënime më të larta se sa dënimet e shqiptuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në pajtim me nenin 390 paragrafi 1 të KPPRK-së, për të cilën nuk i ftoi palët në rastin konkret kemi të bëjmë me dënime me gjobë dhe pretendimet ankimore janë vetëm lidhur me sanksionin penal andaj prezencës së paleve nuk është e obliguar.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Prizren, dhe gjeti se:

- Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të Kosovës të njëjtin e shqyrtoi në këtë aspekt sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 të KPPRK-së dhe konstatoi se nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

As gjendja faktike nuk ka qenë objekt shqyrtimi ngase të akuzuarit gjatë shqyrtimit fillestar të datës 06.11.2023 në bazë të nenit 242 të KPRK-së kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat janë akuzuar, i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare nga të akuzuarit. Pranimi i fajësisë ka mbështetur në faktet që përmban aktakuza dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës. Nga një gjendje e tillë e vërtetuar faktike del që në rastin konkret drejtë është aplikuar edhe ligji penal.

Sa i perket vendimit mbi sanksionin penal Prokurorisë Themelore ne Prizren, me ankesë pretendon se Gjykata e shkalles se pare me rastin e shqiptimit te dënimeve me gjobë ndaj të akuzuarve, i ka mbivlerësuar rrethanat lehtesuese si pranimin e fajësisë per veprën penale te kryer, pendimin, kërkim faljen, premtimin se ne te ardhmen nuk do te kryejnë vepra tjera penale mirëpo nuk i ka vlerësuar rrethanat renduese si dashjen direkte te kryerësve per kryerjen e veprës penale, rrethanat dhe mënyre e kryerjes se veprës penale, e sikur keto rrethana te ishin vlerësuar ne menyre te duhur eshte dashur qe te akuzuarve te iu shqiptoje dënime më të larta e të cilat dënime do te ishin ne proporcion me shkallen e rrezikshmerise, menyren e kryerjes si dhe pasojen e shkaktuar dhe se me denimin e shqiptuar nga ana e gjykates se shkalles se pare nuk mund te arrihet qellimi i denimit i parapare me nenin 38 te KPRK-se, andaj ka propozuar qe ankesa e Prokurorisë Themelore ne Prizren te aprovohet si e bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosoves, vlerësoi pretendimet ankimore lidhur me sanksionin penal te Prokurorisë Themelore ne Prizren per shqiptimin e dënimeve më të larta dhe pas vlerësimit te njëjtës, dhe duke i patur parasysh rrethanat e cekura më lartë dhe rrethanat e rastit konkret, Gjykata e Apelit konstaton se Gjykata e shkalles se pare drejte dhe ne menyre te plote i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese nga neni 69, 70, 71 dhe 72 te KPRK-se te cilat ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit, andaj konstaton se dënimet e shqiptuara me gjobë ndaj të akuzuarve nga ana e gjykates se shkallës së parë janë në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale të kryera, andaj e refuzoi si te pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore ne Prizren për shqiptimin e dënimeve më të larta, duke e vërtetuar aktgjykimin e Gjykates se shkalles se pare, e me bindje se me dënimet e shqiptuara nga ana e Gjykates se shkalles se pare, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i tyre, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.1617/23 më 04.01.2024

Procesmbajtësi
Arben Arifi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetar i kolegjit
Skender Çoçaj

Zyhdi Haziri
